REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1392
Data/Datum/Date: 22/10/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 251 /2026
Datë: 22 . 10 .2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 10 dhe 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 354 (paragrafi 1, 2 dhe 3) dhe nenit 355 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-118 dhe Ligjin Nr. 08/L-102, në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr. 08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Kushtrim Musa, Përmbarues Privat në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, emërohet zëvendësues i Përmbaruesit Privat z. Argjent Xheladini.

2. Zëvendësuesi i përmbaruesit privat nga pika 1 e këtij vendimi ka të njëjta të drejta, detyra dhe përgjegjësi sikur përmbaruesi privat, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Gjatë periudhës së zëvendësimit, zëvendësuesi nga pika 1 e këtij vendimi kryen veprimet përmbarimore për zbatimin e akteve zyrtare të adresuara për përmbaruesin privat që zëvendësohet bazuar në afatet ligjore të përcaktuara.

4. Përmbaruesi privat i zëvendësuar i jep zëvendësuesit të përmbaruesit privat qasjen në të dhënat e tij siç kërkohet për zëvendësimin.

5. Pas skadimit të afatit të zëvendësimit , zëvendësuesi i përmbaruesit privat i jep përmbaruesit të zëvendësuar përshtatshmërish qasje në të dhënat si në pikë 4 të këtij vendimi.

6. Mandati i të emëruarit fillon me datë 23.10.2026 deri më datë 21.01.2027.

7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datë 13.10.2026 Komisioni Disiplinor për Përmbarues Privat ka nxjerr Vendimin DPSDPLS. nr. 22/2026 (me nr. prot. 01-829/4 datë 21.10.2026) sipas të cilit Përmbaruesi Privat z. Argjent Xheladini është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 368 paragrafi 1, nënparagrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndët përmbarimore P.nr. 1393/2026, P.nr. 2835/2026, P.nr. 1678/2026, P.nr. 2814/2026, P.nr. 2426/2026 dhe P.nr. 2834/2026 e iniciuar nga Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Përmbaruesve Privat.

Për përgjegjësinë disiplinore, përmbaruesit privat z. Argjent Xheladini, me Vendimin DPSDPLS. nr. 22/2026 të dt. 13.10.2026 (me nr. prot. 01-829/4 datë 21.10.2026), i është shqiptuar masa disiplinore: *"ndalim i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve"*, e paraparë në nenin 368 paragrafi 1, nën paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Andaj, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore brenda afatit ligjor, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla-Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- *Përmbaruesit privat zëvendësues z. Kushtrim Musa;*
- *Përmbaruesit privat të zëvendësuar z. Argjent Xheladini;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Odës së Përmbaruesve Privat;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*